

# Nis zbatimi i projektit 400 milionë dollarësh i BB-së për rrugët rurale

**FONDI SHQIPTAR** i Zhvillimit prezantoi dje fillimin e zbatimit të projektit të ri që financohet nga Banka Botërore, me vlerë 400 milionë USD, për ndërtimin e rrugëve dytësore dhe lokale në Shqipëri. Në konferencën e organizuar me këtë rast mori pjesë zëvendëskryeministri Gazmend Oketa, në cilësinë e kryetarit të bordit të FSHZH-së, drejtori i programit të transportit të Bankës Botërore, Martin Humphreys, si edhe përfaqësues të tjerrë të qeverisjes qendrore dhe lokale. Në fjalën e tij, zv.kryeministri Oketa prezantoi projektin, si dhe vlerësoi mbështetjen e Bankës Botërore për zbatimin e projekteve të tillë. Oketa

tha se, "ky është një projekt ambicioz i qeverisë shqiptare i mbështetur nga BB dhe që do të realizohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Me anë të këtij projekti, qeveria do të synojë të rrisë përpjekjet konkrete për përmirësimin e infrastrukturës në vend, si edhe përshtimin e aksesit ndaj shërbimeve themelore dhe tregjeve ekonomike, veçanërisht në zonat rurale". Në fund të këtij projekti, i cili do të zgjasë 5 vjet, parashikohet të ngrihet jo vetëm një rrjet dytësor dhe komunal i përmirësuar në mënyrë rrënjosore, por edhe një inventar i rifreskuar i të gjitha rrugëve rajonale, duke mundësuar njojhen në kohë reale të nevojave për

investim dhe për mirëmbajtjen e tyre. Zv.kryeministri Oketa tha se, komponentët kryesorë të këtij projekti do të jenë përmirësimi i seksioneve prioritare të rrjetit dytësor dhe lokal të rrugëve në gjithë Shqipërinë, futja e kontratave të mirëmbajtjes duke kontraktuar sektorin privat për rrjetin lokal të rrugëve, fuqizimi i organizmave përgjegjës për manaxhimin e rrjetit rrugor lokal dhe konsolidimi i përgjegjësive institucionale për manaxhimin dhe planifikimin nga sektori i rrugëve sekondare. Drejtori ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Benet Beci, foli rreth aktiviteteve kryesore dhe hapat e ardhshëm për fillimin e punës.

Objktivi i FSHZH-së është lidhja e kontratave të para të punimeve civile në periudhën korrik-qershor 2008. I gjithë projekti do të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me njësitë e qeverisjes vendore. Sipas Becit, kriteret kryesore për përzgjedhjen e projekteve për financim do të përfshijnë: ndikimin e projektit në zhvillimin social e ekonomik të zonës, gjendjen ekzistuese të rrugës së propozuar, numrin e përfituesve, raportin financiar kosto/përfitim, etj. Kriteret do të bëhen publike para vlerësimit dhe do të konsultohen me të gjithë të interesuarit, në mënyrë që të arrihet një përzgjedhje sa më e mirë.

punim me ministritë e Financave, zhvilloi dje ankandin e radhës për shitjen e bonove të thesarit të qeverisë. Sipas departamentit të operacioneve monetare pranë kësaj banke, në këtë ankand Ministria e Finançave nxorri për shitje bono thesari me maturim 3-mujor 3.1 miliardë lekë, të cilat do të përdoren për Bankën e Shqipërisë dhe për bankat e nivelit të dytë. Këto bono do të emetoohen më 14.03.2008. Nga totali prej 3.3 miliardë lekësh, 2.14 miliardë do të jenë bono me maturim 3-mujor, që do të përdoren për Bankën e Shqipërisë, pjesa tjeter do të përdoret për bankat e nivelit të dytë. Në ankandin e zhvilluar javën e kaluar u shitën bono me maturim tremujor, me një vlerë prej rrith 3.1 miliardë lekësh.